

Raporti i Monitorimit për MZHETTS, për 9-mujorin e vitit 2016.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën ekonomike, të turizmit, të tregtisë dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim rritjen ekonomike, të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, konvergjitimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës dhe shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes administron dhe menaxhon fondet publike sipas 4 programeve buxhetore të miratuara si vijon:

1. Programi “**Planifikim, Menaxhim, Administrim**”
2. Programi “**Mbështetje për Zhvillim Ekonomik**”
3. Programi “**Mbështetje për Mbikqyrjen Tregut, Infstruktura e Cilësise e Pronësi industriale**”
4. Programi “**Zhvillimi i Turizmit**”

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet dhe funksionet e sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat dhe objektivat e MZHETTS-së, duke pasur si synim përdorimin sa më eficient të burimeve publike, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, për të realizuar objektivat dhe qëllimet e përcaktuara për vitin 2016.

Buxheti i miratuar, për sistemin e MZHETTS-së, (për 12 institucionet), në fillim të vitit ka qenë 2,782 milion lekë, Buxheti i rishikuar 2.488 milion lekë te cilat sipas strukturës buxhetore ato paraqiten:

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani i rishikuar 2016	Plani 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	591,400	525,863	386,349	320,989	83
Shpenzime të tjera korente	387,500	522,819	459,364	332,032	72
Investime të brendshme	779,094	757,858	757,858	92,629	12
Financime të huaja	1,024,000	682,000	511,500	284,658	56
TOTALI	2,781,994	2,488,540	2,115,071	1,030,308	49

Referuar kësaj tabele, realizimi i treguesve buxhetor për 9/mujorin e vitit 2016, është 49 %. Më poshtë analizojmë faktorët që kanë ndikuar në realizimin e ulët:

❖ **Shpenzimet e Personelit**, realizuar në masën 83 %:

- Mosplotësimi të vendeve vakante në strukturat e institucioneve, për shkak të ligjit të ri të statusit të nëpunësit civil si dhe procedurave nga Departamenti i Administratës Publike.
- Raporteve të zgjatura mjeksore, pagesat e të cilave kryhen nga Sigurimet Shoqërore.
- Ndryshimet në strukturë dhe organikat e tyre, si dhe bashkimi i institucioneve QKR+QKL në QKB, mbyllja e institucionit ZSHT.
- Fillimi nga funksionimi, i “**Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut**”, në muajin Qershor 2016 dhe mosplotësimi i organikes të këtij institucioni (vetëm 25 nga 90 punonjës).

❖ **Shpenzimet e tjera korente**, janë realizuar në masën 72 %:

- Shpenzimet bazë të funksionimit të veprimtarisë së ministrise kanë qënë të qëndrueshme, të planifikuara sipas regjistrimit të parashikimit publik, por realizimi i ulët vjen si rrjedhojë e bllokimit të veprimtarisë financiare në thesar, nga shoqëritë përmbarimore;
- Si rezultat i diferencave, në disa raste si pasojë e procedurave të prokurimit vlera e prokuruar rezulton më e ulët se ajo e planifikuar, duke sjellë si rezultat mosshpenzim në fondin e planifikuar;
- Procedurat e zgjatura të prokurimit për mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemit elektronik të QKB të cilat kërkuar më shumë kohë nga çfarë ishte parashikuar, duke përfshirë edhe kohën e miratimit të këtij projektit nga AKSHI;
- Mosrealizimi i grantit për shkak të kryerjes së procedurave të prokurimit njëkohësisht me fondin e bashkive ku janë vendosur sportelet e QKB-së;
- Bashkimi i institucioneve (QKR+ QKL, në QKB), si dhe krijimi i institucionit të ri (ISHMT) siç është përmendur edhe me sipër, si dhe mbyllja e ZSHT;
- Vonesa të faturave nga vendet organizatore të panairëve ndërkombëtare, për pjesëmarrjen në këto panairë.

❖ **Duke analizuar realizimin e Investimeve të brendshme, rezulton se shpenzimet për investime** janë realizuar në masën 12 %:

- Procedurat e zgjatura për miratim të fondeve në zërin “Blerje paisje kompjuterike” nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Procedurat e zgjatura të tenderit nga Ministria e Punëve të Brendshme, si rrjedhojë lidhja e kontratave me operatorët fitues u bë në muajin shtator;
- Për vonesë në paraqitjen e faturave për likuidimin e TVSH-së, pranë Ministrisë;
- Diferencat nga procesi prokurimeve, ndërmjet fondeve të planifikuara dhe atyre të kontraktuara;
- Mos funksionimi i plotë i ISHMT-s, solli mospërcaktimin e selisë të këtij Institucioni dhe si pasojë nuk u realizuan investimet e planifikuara për ISHMT-n;
- Bashkimi i dy institucioneve QKR+QKL, riplanifikimi i fondeve të investimeve në funksion të QKB;
- Mos plotësimin e kushteve të kontratës të operatorit fitues të projektit të DPM, për shkak të procedurave të zgjatura nga shteti i kompanisë fituese;
- Ndryshimi i disa projekteve me kërkesë të Kryeministrisë, siç janë rastet e përdorimit të fondeve të AIDA-s prej 29 mln lekë për projektin “Krijimin e fondit në mbështetje të mikrondërmarrjeve, të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitetet në zonat turistike/historike”, (VKM është miratuar në 22.06.2016);
- Natyra e projekteve të AIDA-s, të cilat 50% të vlerës disbursohen pas përzgjedhjes nga aplikimi dhe 50% të vlerës në fund të vitit, si dhe Fondit “Mbështetje për Turizmin” të cilat 30% e fondit disbursohen me lidhje të kontratës dhe 70% të vlerës në përfundim të projektit, deri në fund të vitit 2016.

- ❖ Gjatë vitit 2016, priten të realizohen 25 projekte, me impakt direkt tek biznesi dhe qytetari, me vlerë prej 564 mln lekë:
 - Fondi i Konkureshmerise 32 mln lekë
 - Fondi Inovacionit 5 mln lekë
 - Biznese të Mbështetura me Fondin Start-up 10 mln lekë
 - Publikim në revistat ekonomike ndërkombetare 27 mln lekë
 - Mbështetje biznesit kreativ 10 mln lekë
 - Krijimin e fondit në mbështetje të mikrondërmarrjeve, të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitetet në zonat turistike/historike 29 mln lekë
 - Krijimi i funksionaliteteve të Reja në sistemin e QKB 29 mln lekë
 - Krijimi i moduleve të reja dhe i raportimeve për formularët e bashkimit ndërkufitar në sistemin e QKB-së dhe shërbimeve të tjera 49 mln lekë
 - Krijimi i Portalit të Qendrës Kombëtare të Biznesit 15 mln lekë
 - Rregjistri i koncesioneve /partneriteti publik privat, 5 mln lekë
 - Sistemi informatik për menaxhimin e të dhënave të standardizimit 8 mln lekë
 - Kompletimi i laboratorit të DPM-së, me pajisje edhe instrumenta 24 mln lekë
 - Projekti për zbatimin e Brandit Shqiptar "Go Your own Way" 63 mln lekë
 - Panairi Ndërkombetar CMT Shtutgart 2017 17 mln lekë
 - Promovimi i Strategjive për Nxitjen e Turizmit 45 mln lekë
 - Modeli i promovimit të integruar të Turizmit Shqiptar 10 mln lekë
 - Fondi për mbështetjen e Turizmit 39 mln lekë
 - Ngritja e Pikave "InfoPoint" 15 mln lekë
 - Sinjalistika e Vijës Bregdetare 20 mln lekë
 - Krijimi i Infrast. turistike midis zonave bregdetare/malore 29 mln lekë
 - Plani i menaxhimit për itineraret turistik Via Egnatia 10 mln lekë
 - Projekti studimor MICE (produkte turistike) 10 mln lekë
 - Projekti Zhvillimi i sistemit RDHSAT 8 mln lekë
 - Administrimi Elektronik i të Dhënave për Pronat Shtetërore 15 mln lekë
 - Projekti për ekspertizën për projektimin ndertimin, mirembajtjen dhe menaxhimin e Portit të Karpenit 40 mln lekë

❖ **Lidhur me Financimin e Huaj**, janë realizuar në masën 56 %, nga ku:

- **Projekti “Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri nëpërmjet një linje kredie për SME-të dhe sigurimiun e Asistencës Teknike për to”** nga 277,500 mijë lekë të planifikuara për 9/mujorin e parë të vitit 2016, janë realizuar 132,426 mijë lekë ose 48 %.

Në bazë të Marrëveshjeve ligjore midis Qeverisë Shqiptare dhe Italiane, Programi është krejtësisht i përjashtuar nga vendimmarrja në financimin e Projekteve të SME-ve. Kërkesat e subjekteve për financimin e projekteve nuk paraqiten në PMU, por në Bankë, e cila nga kriteret e larta për të shmangur riskun ka ndikuar në realizim. Pavaresisht nga kjo, Programi Italian për zhvillimin e SME-ve në Shqipëri është një ndër programet më të suksesshme të viteve të fundit në Shqipëri, i aftë të ndihmojë konkretisht dhe shpejt me likuiditet sipërmarrjet shqiptare, sidomos në këtë periudhë shumë të vështirë dhe delikate që po kalon jo vetëm ekonomia jonë, por mbarë ekonomia evropiane.

Të analizuar sipas programeve treguesit buxhetor paraqiten:

1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim” për 9/mujorin e vitit 2016 është analizuar sipas strukturës buxhetore:

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani i rishikuar 2016	Plani 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	181,900	134,900	102,025	100,494	98
Shpenzime të tjera korrente	112,000	242,256	241,257	181,157	75
Investime të brendshme	111,100	111,100	111,100	11,428	10
Financime të huaja	280,000	288,000	216,000	152,232	70
TOTALI	685,000	776,256	670,382	445,311	66

Pagat dhe sigurimet shoqërore, nga 102,025 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 100,494 mijë lekë ose 98 %.

Shpenzimet e tjera korrente, nga 241,257 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 181,157 mijë lekë ose 75 %.

Investimet Publike të Brendshme

- **Fondi për mbështetjen e Turizmit**, me vlerën 39 mln lekë, pritet të realizohet 100%. Janë lidhur pesë kontratat dhe janë hapur sërish thirjet për projekte të reja.
- **Administrimi Elektronik i të Dhënave për Pronat Shtetërore, të dhënat e Zonave Ekonomike dhe Informatizimi i shërbimeve për pronat shtetërore**, me vlerën 15 mln lekë, është në proces implementimi do të realizohet 100%. Ky projekt do të sjelli gjenerimin e të dhënave në kohë reale dhe informatizimin e shërbimeve për pronat shtetërore.
- **Projekti Zhvillimi i sistemit RDHSAT-Regjistri i të Dhenave nga sipërrmarjet akomoduese**, me vlerën 8 mln lekë, pritet të realizohet 100%. Regjistrimin e të dhënave akomoduese të turistëve, ky projekt do të gjeneroj të dhëna, të cilat do të jenë në funksion të përcaktimit të indikatorve për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, si dhe në hartimin e politikave dhe planeve të reja për turizmin, në mbështetje me Direktivën e BE-së për të dhënat statistikore.
- **Projekti studimor MICE**, me vlerën 10 mln lekë pritet të realizohet 100%, pagesa do të kryet në bazë të faturave të paraqitura nga operatori fitues, për çdo fazë të implementimit të projektit i cili përfundon në dhjetor.

Investime kapitale të huaj, nga 216,000 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 152,232 mijë lekë ose 70 %. Në këtë masë realizimi, kanë ndikuar vonesat në disbursimet e kësteve të dyta nga donatorët e huaj.

2. Programi “**Mbështetje për Zhvillim Ekonomik**” për 9/mujorin e vitit 2016 është analizuar sipas strukturës buxhetore:

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani i rishikuar 2016	Plani 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	113,000	107,818	79,729	72,949	92
Shpenzime të tjera korrente	126,000	127,882	103,466	75,929	73
Investime të brendshme	214,994	244,994	244,994	56,477	23
Financime të huaja	670,000	370,000	277,500	132,426	48
TOTALI	1,123,994	850,694	705,689	337,781	48

Ky program zë peshën më të madhe në Ministri, për nga madhësia e fondeve buxhetore, mbi 40 % e fondeve të planifikuara për sistemin e MZHETTS-së dhe përgjegjësia për të realizuar qëllimin dhe objektivat e politikës së tij është vlerësuar nga institucionet pjesëmarrëse, si njësi zbatuese, për të shërbyer krijimit të një klime pozitive, për zhvillimin e biznesit, krijimit të vendeve të reja të punës, reduktimit të informalitetit dhe krijimit të një mjedisi konkurrues, për zhvillimin e investimeve.

Pagat dhe sigurimet shoqërore, nga 79,729 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 72,949 mijë lekë ose 92 %.

Shpenzimet e tjera korrente, nga 103,466 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 75,929 mijë lekë ose 73 %.

Investime kapitale të brendshme.

- **Fondi i Konkrueshmerise**, me vlerën 32 mln lekë, pritet të realizohet 100%. Objektivi i këtij fondi është të ndihmojë kompanitë shqiptare të depërtojnë me eksportet e tyre në tregjet e huaja, duke siguruar mbështetjen e nevojshme financiare për aktivitete që do të ndihmojnë në zbatimin e planit të tyre të marketingut për eksport. Fushat kryesore që mbulon fondi janë prodhimi dhe shërbimi, më konkretisht: Sektori i industrisë së përpunimit, sektori i agropërpunimit, sektori i industrisë së lehtë, sektori i kërkimit dhe zhvillimit.
- **Fondi Inovacionit**, me vlerën 5 mln lekë, pritet të realizohet 100%. Fondi i Inovacionit u jep ndihmë, në formë granti të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Qëllimi i Fondit është t'i shtohet buxhetit të ndërmarrjes, duke shërbyer si një nxitje për inovacion dhe teknologji, të ndihmojë dhe lehtësojë promovimin dhe licencimin apo patentimin e inovacioneve.
- **Biznese të Mbështetura me Fondin Start-up**, me vlerën 10 mln lekë, pritet të realizohet 100%. Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja "Start-up" është krijuar për t'i shërbyer Ndërmarrjeve Mikro dhe të Vogla që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në: Sektorët prodhues dhe të shërbimit, sektorin e industrisë së lehtë, sektorin e turizmit, fushën e kërkimit dhe të zhvillimit, procesin e agropërpunimit, fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.
- **Publikim në revistat ekonomike ndërkombetare**, me vlerën 27 mln lekë, realizuar 100 %. Një numër prej 5 000 kopjesh të revistës janë shpërndarë në Forumin Ekonomik
- Botëror, qëllimi i këtij publikimi është të krijojë një dialog për investime në Shqipëri dhe ta kthejë Shqipërinë në rekomandim kryesor për investime të huaja.
- **Edhe unë kam një ëndër 2015**, me vlerën 6.3 mln lekë, është në proces realizimi.

- **Krijimi i funksionaliteteve të reja në sistemin e QKB për përthithjen automatike të situatës aktuale tatimore (DDPT, NJQV) dhe miratimin e ushtrimit nga AKU, me vlerën 29 mln lekë është në proces implementimi, likuidimi do të bëhet në muajin dhjetor.**
- **Krijimi i moduleve të reja dhe i raportimeve për formularët e bashkimit ndërkufitar në sistemin e QKB-së dhe aplikimeve online për bashkimin ndërkufitar dhe shërbimeve të tjera, me vlerën 49 mln lekë, në proces për lidhjen e kontratës. Projekti do të sjelli lehtësi në procedurat e bizneseve, si vendas dhe të huaj. Krijimi i këtyre sistemeve online do të sjelli gjenerim të dhënash në kohë reale.**
- **Rregjisti i koncesioneve / partneritetit publik privat, me vlerën 11 mln lekë. Për herë të parë vendoset sistemi informatik për menaxhimin e të dhënave mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat në Republikën e Shqipërisë, i cili synon të jetë një sistem informues online, qe lehtëson përjasjen e organeve shtetërore dhe të sipërmarrësve privatë të cilët angazhohen në procedurat e koncesioneve dhe të partneritetit publik privat (PPP). Regjistri do të përmbajë të dhëna në lidhje me: autoritetin kontraktues; objektin e kontratës së koncesionit/PPP, llojin e kontratës, vendndodhjen e objektit, kohëzgjatjen e kontratës, vlerën e kontratës, tarifën koncesionare, çmimin e shërbimit publik në rast se ka, si dhe do të mundësojë që publiku të aksesojë tekstin e plotë të secilës kontratë. Projekti është në fazën e implementimit, likuidimi do të kryet në muajin nëntor.**

3. Programi “Mbështetje për Mbikqyrjen Tregut, Infrastukturën e Cilësive e Pronësi Industriale” për 9/mujorin e vitit 2016 është analizuar sipas strukturës buxhetore:

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani i rishikuar 2016	Plani 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	230,500	227,080	166,421	110,669	67
Shpenzime të tjera korrente	57,000	57,846	46,014	37,231	81
Investime të brendshme	140,500	140,500	140,500	10,505	8
Financime të huaja	50,000	0	0	0	0
TOTALI	478,000	425,426	352,935	158,405	45

Në këtë Program janë realizuar objektivat e identifikuara në politikën e tij, nëpërmjet mbështetjes dhe promovimit të përdorimit të standardeve europiane e ndërkombetare, Adoptimin e standardeve shqiptare, duke promovuar përdorimin e atyre Europiane, mbështetjes së pronësisë industriale, dhe zhvillimit të tregtisë dhe konkurrencës së ndershme, mbrojtjen e markave, patentave dhe regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, nëpërmjet vlerësimit të aplikimeve, kërkesave për regjistrim për shpikje të depozituar, aplikimeve për ripërtëritje dhe ndryshimeve të kërkuar për marka dhe patenta.

Pagat dhe sigurimet shoqërore, nga 166,421 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 110,669 mijë lekë ose 67 %.

Shpenzimet e tjera korrente, nga 46,014 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 37,231 mijë lekë ose 81 %.

Investime kapitale të brendshme,

- **Sistemi informatik për menaxhimin e të dhënave të standardizimit, praktikave, shërbimeve**, me vlerën 8 mln lekë pritet të realizohet 100%. Krijimi i bazës së të dhënave

shtetërore për Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS). Baza e të dhënave parësore dhe dytësore të SMS-së janë, si më poshtë vijon:

Standardet shqiptare dhe dokumentet e standardizimit;
 Cikli i jetës së standardeve shqiptare;
 Të dhëna për shitjet e standardeve;
 Të dhëna për klientët dhe palët e interesuara;
 Të dhëna për punën teknike të standardeve.
 Standardet e organizatave evropiane (CEN, CENELEC, ETSI);
 Standardet e organizatave ndërkombëtare (ISO, IEC dhe ITU-T).

- **Kompletimi i laboratorit të DPM-së, me pajisje edhe instrumenta matës,** me vlerën 24 mln lekë. Qëllimi i rritjes së standardeve në 10 fusha të matjes. Vëmë në dukje se Projekti “Ngritja e Laboratorit të kohë frekuences dhe vazhdim i kompletimit të laboratorit ekzistues të DPM-së, me pajisje edhe instrumenta matës”, të DPM (prej 103 mln lekë), nuk u realizua për shkak procedurave të tenderimit të cilat ishin mjaft të zgjatura për shtetin e kompanisë fituese dhe tejkalonin vitin buxhetor aktual.

4. Programi “**Zhvillimi i Turizmit**” për 9/mujorin e vitit 2016 është analizuar sipas strukturës buxhetore:

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2016	Plani i rishikuar 2016	Plani 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016	Realizimi faktik 9/mujorit 2016 në %
Paga dhe Sigurimet	66,000	56,065	38,174	36,878	97
Shpenzime të tjera korrente	92,500	94,835	68,626	37,714	55
Investime të brendshme	312,500	261,264	261,264	14,219	6
Financime të huaja	24,000	24,000	18,000	0	0
TOTALI	495,000	436,164	386,064	88,811	23

Institucionet që përfshihen në të janë angazhuar në realizimin e objektivave, brenda fushës së përgjegjesisë shtetërore, në sensibilizimin e vizitorëve, organizimin e veprimtarive turistike, promovimin e resurseve turistike lokale, organizime takimesh me gazetarët e huaj turistikë për mundësinë e bashkëpunimit si dhe gjetjen e mënyrave më të mira për promovimin e turizmit. Ka patur një përmirësim të jashtëzakonshëm dhe një rritje eksponenciale nëpërmjet pjesëmarrjes në panairët ndërkombëtarë më të rëndësishëm të turizmit, si: panairi WTMO i Londrës; Panairi i Beogradit; Panairi i Budapestit, Ferien Messe, Vjenë; FITUR, Madrid, Spanjë; BIT, Milano, Itali; ITB Berlin, Gjermani, Panairi JATA Tourism Expo Tokyo, Japoni; Panairi IFTM TOP RESA Paris, France si dhe në panairët e tregjeve të synuara si Rusia, Çekia, Kosova etj.

Pagat dhe sigurimet shoqërore, nga 38,174 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 36,878 mijë lekë ose 97 %.

Shpenzimet e tjera korrente, nga 68,626 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 37,714 mijë lekë ose 55 %.

Investimet kapitale të brëndshme:

- **Projekti per zbatimin e Brandit Shqiptar "Go Your own Way"**, me vlerën 63 mln lekë, pritet të realizohet 100%. Promovimin e turizmit Shqiptar në arenën ndërkombëtare duke u prezantuar dhe me një brand të ri **"Go Your own Way"**, si dhe prezantimin e Shqiperisë në panairët ndërkombëtare. (Shtutgart, Paris, Londër, Milano, Madrid, Beograd, Berlin, Vjen, Prag, Budapest, etj.)
- **Modeli i promovimit të integruar të Turizmit Shqiptar**, me vlerën 10 mln lekë, pritet të realizohet 100%. Për shkak të zhvillimeve të fundit teknologjike informacioni turistik duhet të përshtatet me këto risi të shërbimit dhe të serviret sipas nevojave që ne iu ofrojmë vizitorëve vendas e të huaj. Për të realizuar objektivat do të vendosen 12 Ekran Videowall të cilat do të shërbejnë si portë kreative e komunikimit me turistët. Këto ekran do të komunikojnë vlerat dhe traditën shqiptare dhe po ashtu bazohet në strategjinë e komunikimit të Agjencisë Kombëtare të Turizmit.
- **Ngritja e Pikave "InfoPoint"**, me vlerën 15 mln lekë, pritet të realizohet 100%. Qëllimi i realizimit të projektit është marrja e informacionit për turizmit në kohë reale.
- **Sinjalistika e Vijës Bregdetare**, me vlerën 20 mln, pritet të realizohet 100%. Ngritja e sinjalistikës së plazheve, venia e tabelave me informacione bazike në plazhet gjatë vijës bregdetare për informimin e pushuesve në lidhje me të dhenat e plazhit si dhe mënyrat e kontaktit me shërbimet e urgjences për sigurinë në plazhe, pra ngritjes së sinjalistikës me standartet ndërkombëtare.
- **Krijimi i Infrastruktues Turistike midis zonave bregdetare dhe zonave malore**, me vlerën 20 mln, pritet të realizohet 100%. Promovimi dhe monitorimi i projekteve, ndjekjen e zhvillimit të zonës bregdetare e të planeve të miratuara nga autoritetet e planifikimit. (shtigje, tabela informuese, promocion, GIS, restaurim i strukturave akomoduese që ofrojnë shërbimin e fjetjes dhe mëngjesit brenda çmimit të dhomës (B&B), website specifik).
- **Plani i menaxhimit per iteneraret turistik Via Egnatia**, me vlerën 10 mln, pritet të realizohet 100%. Itenerari turistik Borsh-Kurvelesh- Zagori është një itenerar që paraqet një potencial të madh zhvillimi. Ky plan menaxhimi do të shërbeje për të caktuar strategjinë e zhvillimit, synimet afatshkurtra dhe afatmesme dhe plan veprimi të detajuar. Itenerari turistik Borsh-Kurvelesh- Zagori është një itenerar që paraqet një potencial të madh zhvillimi.

Në kuadër të menaxhimit me efektivitet të Aktiveve në pronësi dhe përdorim të njësive të sistemit të MZHETTS-së, janë ndjekur procedurat standarde lidhur me dokumentimin, (regjistrin e tyre), ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi. Është ndjekur dhe monitoruar parandalimi dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura financiare, në kuadër të VKM nr.50, datë 05.02.2014, “ Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e planit të veprimit”, për të moskrijuar detyrime të reja. dhe marrjen e masave të duhura për kryerjen e pagesave, duke respektuar afatet, dhe monitorimin e tyre të vazhdueshëm.

Vlen të theksohet se përdorimiri i Fondit të Veçantë është bërë sipas kriterëve të përcaktuara në VKM Nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” Fondi i veçantë për 9/mujorin e parë të vitit 2016 është përdorur me një vlerë 456,200 lekë.

Një zë i rëndësishëm i të ardhurave, janë të ardhurat nga qerata të cilat realizohen nga dhënia në përdorim të aseteve shtetërore. Për 9/mujorin e vitit 2016, të ardhurat nga qerata janë realizuar në vlerën 23.8 mln lekë, nga të cilat 8.5 mln lekë i takojnë MZHETTS. Nga këto janë përdorur në vlerën prej 6.2 mln lekë për shoqëritë në vërshtirësi financiare, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar,

MINISTRI

MILVA EKONOMI